

V E N D I M
Nr.616, datë 9.9.1996

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.186, DATË
18.3.1996 “PËR SHPEJTIMIN E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË PRIVATIZUARA”**

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika II.1 të ndryshojë:

“1. Gjendjet monetare në arkë ose në bankë të ndërmarrjeve në likuidim të tërhiqen menjëherë dhe të derdhen pranë degëve të thesarit në rreth. Këto të ardhura të përdoren për shpenzimet që lidhen me procesin e likuidimit, si dhe likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, sipas procedurave për përdorimin e të ardhurave. Llogaritë e tyre bankare mbyllen”.

2. “Të ardhurat e krijuara nga mbyllja e llogarive bankare të ndërmarrjeve në likuidim të administrohen nga ministritë për ndërmarrjet nacionale dhe Sekretariati i Shtetit për Pushtetin Lokal për ato lokale, duke pasur të drejtën e rishpërndarjes ndërmjet ndërmarrjeve të vartësisë që janë në likuidim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi